



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.411/2025**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në hapësirat publike në Istog, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 09.02.2025, mori këtë:

### **V E N D I M**

Refuzohen të pabazuar ankesat Anr.411/2025, Anr.413/2025, Anr.414/2025, të datës 01.02.2025, të parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

### **A r s y e t i m**

Me datën 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuar me numër Anr.411/2025, Anr.413/2025, dhe Anr.414/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Në ankesën A.nr.411/2025, pretendohet se me 6 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Prishtinë, kanë identifikuar baner/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike, konkretisht në rrugën publike "Besim Kabashi" në qendër të Gurakocit, të kandidatit për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës LDK, Shkëmb Manaj.

Po ashtu në ankesën A.nr.413/2025, pretendohet se me 6 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Prishtinë, kanë identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike, konkretisht në rrugën publike " Besim Kabashi " në qendër të Gurakocit, të kandidatit për deputete nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës LDK, Serbeze Kabashi Muçaj.

Në ankesën A.nr.414/2025, pretendohet se me 6 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Prishtinë, kanë identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike, konkretisht në rrugën publike "Ibrahim Rugova" në Istog, të kandidatit për deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës LDK, Rexhep Kurtbogaj.

Sipas parashtruesit të ankesave theksohet se me këtë veprim kandidatët në fjalë dhe subjekti politik LDK, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP.

Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografit të printuar lidhur me rastin në fjalë. Andaj kërkojnë nga PZAP-i, që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lart cekura, që masa e sanksionit të vendoset sipas legjislacionin në fuqi.

Më datë 07.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesat e paraqitura kundër tyre.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesat, A.nr.411/2025, A.nr.413/2025 dhe A.nr.414/2025, në afatin e përcaktuar ligjor jep këtë përgjigje:

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik LDK, thuhet se kandidatët e subjektit në fjalë nuk kanë bërë shkeljen e dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse disa nga kandidatët për deputet nga radhët e Subjektit Politik LDK, dega në Istog, me rastin e vendosjes së materialeve reklamuese-postereve, posedojnë Pëlqime të përkohshme për shfrytëzim të hapësirës publike, të lëshuar nga Komuna e Istogut — Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.411/2025, Anr.413/2025, dhe Anr. 414/2025 të paraqitura me datë 06.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.411/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara për ankesat nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se "Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që

shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Parashtruesi i ankesave i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, në këtë rast Pëlqimet e leshura nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Istogut, nr.11/351-1562/11, datë 20.01.2025, nr.11/351-2804/15, më datë 22.01.2025, si dhe pëlqimi me nr. 11/351-4727/28 me datë 04.01.2025, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirave publike, konkretisht në rrugën “Ibrahim Rugova”, në Istog, dhe rrugën “ Besim Kabashi” në Gurakoc, për vendosjen e posterave, vërtetoi se posterat e kandidatëve për deputet Rexhep Kurtbogaj, Shkëmb Manaj dhe Serbeze Kabashi, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, të vendosur nga Subjekti Politik LDK, nuk është në kundërshtim me rregullat zgjedhore ngase janë vendosur me pëlqimin e drejtorisë përkatëse të Komunës së Istogut. Andaj vendosja e reklamave nga kandidatët në fjalë nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore dhe njëherit është në pajtim me Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024. Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, konkretisht neni 5 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 “ Të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo në hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë nga parashtruesi i ankesave nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.411/2025 më datën 09.02.2025

**Kryesuesi i Panelit**  
Kujtim Pasali



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.